

Mitropolia e Elbasanit përsëri është përpjekur ti gjendet pranë familjeve në nevojë duke krijuar nisma humane



Kisha Orthodhokse si një 'nënë e dhembshur' vazhdon të përkujdeset duke kryer misionin e saj ne aspektin universal. Ajo i gjendet pranë nevojtarëve dhe jo vetëm, me lutje, mbështetje dhe ndihma ushqimore, duke falur shpresë për ti lehtësuar në keto ditë të vështira.

Dihet tashmë gjendja pandemike që ka përfshirë botën. Lavdi Zotit vihet re përmirësime në statistikat e të prekurve, por nevoja për ndihmë ekonomike vazhdon të jetë e gjymtuar.

Mitropolia e Elbasanit përsëri është përpjekur ti gjendet pranë familjeve në nevojë duke krijuar nisma humane. Këtë herë u krijua mundësia që 150 familje të përfitonin pako ushqimore dhe detergjentë të cilat u siguruan në bashkëpunim me organizatën FOOD BANK Albania. Ndihamat u shpërndanë në këto zona: Elbasan, Peqin, Gramsh, Cërrik, Kuqan, Kryezjarrth, Shelcan, Trapsenisht, Gjinar dhe Zavalinë.

Le të plotësojmë me vepra vullnetin e Perëndisë në tokë dhe në qiell.

....të mos duam me fjalë, as me gjuhë, por me vepra dhe në të vërtetë. (1 Joani 3:18)

